

ALBERT RISKA
Universiteti i Elbasanit

NJË SHUMËSI INTERESANTE ETNONIMESH

(Disa vërejtje mbi etnonimet
që përdoren për të shënuar popullin arumun)

Arumunët janë një popull që jetojnë të shpërndarë në disa vende të Ballkanit, si Shqipëri, Greqi, Maqedoni, Bullgari e Serbi. Përveç etnonimit *arumun*, për të shënuar këtë grup etnik përdoren edhe etnonime të tjera, si *vllah*, *çoban* etj. Për të diferencuar grupet që u përkasin shteteve të ndryshme këtij territori përdoren edhe etnonime specifike, të cilat zakonisht janë kompozita që kanë si element të parë emrin e vendit ku ata jetojnë dhe si element të dytë termin *vllah*, si *shqiptarovllah*, *makedonovllah* e *elinovllah*. Në Greqi përdoret edhe etnonimi *kucovllah*.

Përdoren, gjithashtu, edhe të tjera terma që kanë një shtrirje të kufizuar, por që ngjallin interes për dy arsyet:

Së pari, sepse mbështeten mbi tipare antropologjike a sociopsikologjike të arumunëve, siç është rasti i termit *mavrovllah* (*karavllah* nën influencën turke) që mbështetet në një tipar fizik, apo sarakaçan, që përdoret për të shënuar një grup të markuar nga pikëpamja shoqërore ose sepse mbështeten në tipare të gjuhës së tyre, siç është rasti i termit *cincar* përmëdonasit e *fucikaci* përmë shqiptarët, që mbështeten, respektivisht, në fjalën arumune *tsintsi* (pesë) e në togun e mjaftpërdorur *futs a casă* (shko në shtëpi). Gjithashtu, nga Dh. Q. Qiriazi¹ kemi faktin që në tregun e Janinës arumunët thirreshin *tzatsi pri tzatsi* dhe kjo nga numri *tzatsi* (dhjetë) dhe parafjala *sper* (mbi) e arumunëve, mësuar nga numrat nga 11 deri 19 ose nga numrat me dhjetëshe të plota që është e natyrshme të përdoren rëndom në një treg. Natyrisht këtu nuk është fjala përmë etnonime të mirëfillta, por përmë nofka që vetëm në qoftë se përhapen e jetojnë gjatë mund të arrijnë vlerën e etnonimit.

Së dyti, sepse tregojnë që njohja e tyre nga popujt e tjerë të Ballkanit nuk ka qenë gjithnjë kaq e thellë dhe e plotë. Përdorimi i një numri relativist të madh termash me vlerën e etnonimit provon që popujt fqinj kanë njohur grupe të caktuar arumunësh dhe nuk kanë qenë të ndërgjegjshëm përmë tëresinë dhe unitetin etnokulturor të tyre. Kemi me këto vlera etnonimet *grabovar*, *frashëriot*, *sarakaçan*, *dënce*.

Edhe vetë arumunët diferencohen brenda përmë brenda tyre përmes etnonimeve *çoban vendi* e *çoban mali*. Kjo ndarje lidhet me faktin se kemi të bëjmë me grupe të ngulitur herët në qendra banimi të caktuara apo me grupe që merreshin përjashtimisht me blektori dhe bënin jetë nomade duke ndjekur tërë kohën kullotat. Çohenjtë e vendit i quajnë çohenjtë e malit *sarakaçanë*, term ky që prej tyre është huazuar nga shqiptarët.

¹ Albanoellenica, 1/1999, faqe 38.

Lista e termave që shënojnë arumunët, qoftë tërësisht apo pjesërisht (pa pretenduar të kemi informacion të plotë për etnonimet apo nifikat që shënojnë grupe të caktuara arumunësh në vendet e tjera ku ata jetojnë) do të na rezultonte kjo: *arumun, vllah, elinovllah, shqiptarovllah, magedonovllah, kucovllah, mavrovllah, karavllah, çoban, çoban vendi, çoban mali, sarakaçan, frashëriot, grabovar, dënce, cincar, fucikaci*.

Më i përhapuri ndër etnonimet e përmendura është etnonimi *vllah*. Eshtë ky etnonimi që, siç përmendëm më lart, rregullisht përbën elementin e dytë me të cilin ndërtohen etnonimet e përbëra e të specifikuara për grupet që jetojnë në shtete të ndryshme.

Vetë arumunët e quajnë veten *arâmân, armân ose râmân*.

Është interesante të vihet re që në shqip e në greqisht ka një lloj diferencimi të etnonimeve që shënojnë këtë popull. Ky diferencim ka të bëjë me përdorimin e këtyre termave në variante funksionale apo situacionale të ndryshme, si edhe me shpërndarjen gjieografike të tyre.

Kështu, sikurse e përmendëm më lart, në shqip termi *çoban* ka një ngarkesë emocionale negative, përcmuese, dhe përdoret me këtë vlerë në thjeshtligjërim, i takon regjistrat të ulët. Ky do të përbënte grup me të gjithë termat që përdoren për nifikë, si *dënce, cincar, fucikaci* etj. Me një farë ngarkese negative përdoret nga çobenjtë e vendit edhe termi *sarakaçan* për të diferencuar si të një stadi shoqëror më të ulët çobenjtë e malit që kanë qenë barinj nomadë.

Termi *vllah* nuk ka në shqip ngarkesë negative, por paraqitet neutral (madje ky është termi më konfidencial) dhe i takon regjistrat të mesëm. Të një vllerë me këtë janë edhe kompozitat që ky ndërton me emrat e popujve me të cilët jetojnë arumunët, si *magedonovllah* apo *elinovllah*.

Nga ana e vet termi *arumun* duket sikur ka fituar një status më të lartë se termi *vllah* (pavarësisht nga frekuanca e përdorimit) pasi është bëritë termi më i hasur në literaturën shkencore shqiptare mbi arumunët, si edhe në vende të tjera.

Për të patur një ide për masën e qytetarisë së këtyre termave besojmë se mjafton t'i referohemi një vërejtjeje interesante që bën A. Pipa² lidhur me numrin e fjalëve që derivojnë në shqip nga etnonimet e popujve të Ballkanit, sipas Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe të vitit 1980. Nga etnonimi *vllah* kemi gjashtë njësi, sikurse edhe prej rrënjos *shqip*: *vllah, vllahe* (emri etnik), *vllahe, vllahisht, vllahishte* (respektivisht mbiemër, ndajfolje, emër që shënojnë gjuhën) *vllahçe* (ndajfolje). Fjalët që lidhen me rrënjen arumun janë pesë. Diferencën e krijon ndajfolja me prapashtesën -çë. Fakti që lidhet me këtë prapashtesë me karakter popullor tregon që termi *vllah* gjëzon njohje të hershme dhe një përhapje të gjerë në shqip. Me rëndësi është të theksohet se me termat që shënojnë popujt e tjerë të Ballkanik shqipja e Fjalorit të vitit 1980 njeh në çdo rast më pak se gjashtë fjalë: turk 5, grek 4, bullgar 4 etj. Arumunët rezultojnë kështu një popull me lidhje më të ngushta me shqiptarët.

² A. Pipa, The Politics of Language in Socialist Albania, USA, 1989, 172.

Një situatë pak a shumë e ngjashme, lidhur me diferencimet në përdorimin e etnonimeve të ndryshme, duket se haset edhe në greqisht. Etnonimi *kucovllah* përdoret me ngarkesë negative. Sikurse edhe në Shqipëri, në greqisht përdoret me ngakesë negative etnonimi *çoban*. Sipas Achille G. Lazarout, në greqisht përdoret me ngarkesë negative edhe etnonimi *vllah*, duke qenë se në greqishten moderne, sidomos në gjuhën e qyteteve, *vllahos* (βλάχος) do të thotë bari, njeri i trashë, i pagdhendur³, por është, gjithsesi, ky term që përdoret i liruar nga këto ngarkesa në ligjërimin bisedor dhe është, gjithashtu, më konfidenciali.

Vetë Lazarou në punimet e tij, që do të përfaqësonin në këtë rast literaturën shkencore greke mbi arumunët, përdor për etnonim termin *arumun*.

Shpërndarja gjeografike e termave bëhet shumë e qartë po ta ndjekim në plan ballkanik Termat *arumun* dhe *vllah* përdoren në gjithë Ballkanin, si edhe jashtë tij.

Etnonimet specifike apo kompozitat që përmendëm më lart të, cilat përdoren në vende të ndryshme, e gjëzojnë shpërndarjen gjeografike nga ndarja politike e Ballkanit. Termi *çoban* përdoret në Shqipëri dhe Greqi. Në Greqi përdoret me dy variante *çoban* dhe *çopan*. Trajta *çopan* përdoret edhe në Shqipëri, në Elbasan. Termi *kucovllah* përdoret në Greqi. Në Greqi përdoret, gjithashtu edhe termi *mavrovllah* dhe varianti *karavllah*. Elementët e tjerë të listës kanë shpërndarje shumë të kufizuar. Kështu, *grabovar* ka vlerën e etnonimit vetëm në Elbasan e Gramsh.

Nuk është dyshuar ndonjëherë që të tre variantet (*arâmân*, *armân*, *râmân*) përbëjnë fazë të evoluara të etnonimit roman.

Etnonimi *çoban* është i lidhur, pa dyshim, me profesionin e blegtorisit, që ka qenë një ndër aktivitetet kryesore ekonomike të arumunëve. Si apelativ e përdorin të gjithë popujt e Ballkanit, edhe ndonjë popull jashtë tij, dhe përbën një huazim turk të përbashkët⁴. Si etnonim e përdorin edhe grekët me trajtat çoban apo çopan.

Me probleme paraqitet nga pikëpamja etimologjike etnonimi *vllah*. Ideja më e pranueshme për filologjinë greke është ajo sipas të cilës termi *vllah* vjen te popujt Ballkanit nga gjermanishtja *valch* dhe kjo nga një më e hershme *valcae* që ka shënuar fise kelte. Pas metatezës së likuideve në sllavisht përftohet trajta e sotme *vllah*. Ky shpjegim gjendet në fjalorë shpjegues e në fjalorë etimologjikë grekë⁵.

Një trajtim etimologjik më të gjerë të termit dhe një histori të mendimeve etimologjike të mëparshme e gjemjë te Lazarou⁶.

³ Achille G. Lazarou, L'aroumain et ses rapports avec le grec, Thessaloniki, 1986, faqe 77.

⁴ E. Çabej, Studime etimologjike në fushë të shqipes III, Tiranë, 1987, f. 128.

⁵ Ελληνικό Λεξικό, Ελευθεροτυπία, Αθήνα, 1993.

Βλάχος <sllav. Vlah <gjerm. vjet. Walh–Volk (f. 152), si edhe Γιάννη Κουλάκη, Το Μεγάλο Ετυμολογικό Λεξικό της Νεοελληνικής Γλώσσας, Μάλλιαρης-Παιδεία, 1993 (f. 269).

⁶ Shih: «L'aroumain et ses rapports avec le grec», ff. 74, 75, 76.

ΑΛΜΠΕΡΤ ΡΙΣΚΑ
Πανεπιστήμιο Ελμπασάν

ΜΙΑ ΕΝΔΙΑΦΕΡΟΥΣΑ ΠΟΛΛΑΠΛΟΤΗΤΑ ΕΘΝΙΚΩΝ

(Παρατηρήσεις επί των εθνικών
που χρησιμοποιούνται για τη δήλωση του αρωμουνικού πληθυσμού)

Περίληψη

Οι Αρωμούνοι είναι λαός που ζει σε μερικές χώρες της Βαλκανικής, συγκεκριμένα στην Αλβανία, Ελλάδα, ΠΓΔΜ, Βουλγαρία και Σερβία. Εκτός από το εθνικό *Αρωμούνοι* [αλβ. *arumun*], για να δηλωθεί η εθνική αυτή ομάδα χρησιμοποιούνται και άλλα εθνικά, όπως *Βλάχος* [αλβ. *vllah*], *Τσοπάνος* [αλβ. *çoban*] κλπ. Για την διαφοροποίηση ομάδων που ανήκουν σε διάφορες χώρες της ευρύτερης περιοχής χρησιμοποιούνται ξεχωριστά εθνικά που ως α' στοιχείο του συνθετικού εμφανίζεται το όνομα της χώρας διαμονής τους και ως β' συστατικό το βλάχικο στοιχείο, π.β. *Αλβανοβλάχος* [αλβ. *shqiptarovllah*], *Μακεδονοβλάχος* [αλβ. *maqedonovllah*] και *Ελληνοβλάχος* [αλβ. *elinovllah*]. Στην Ελλάδα χρησιμοποιείται και το εθνικό *Κουτσοβλάχος* [αλβ. *kucovllah*].

Χρησιμοποιούνται επίσης και άλλες ονομασίες περιορισμένης εμβέλειας, πλην όμως ενδιαφέρουσες για δύο κυρίως λόγους:

Πρώτον, επειδή βασίζονται σε ανθρωπολογικά η κοινωνικο-ψυχολογικά χαρακτηριστικά των Αρωμούνων, όπως λ.χ. *Μαυροβλάχος* [αλβ. *mavrovllah*] (*Καραβλάχος* [αλβ. *karavllah*] υπό την τουρκική επίδραση) ή *Σαρακατσάνος* [αλβ. *sarakacan*], *Τσίντσαρ* [αλβ. *cincar*] στους κατοίκους της ΠΓΔΜ και *Φουτσικάτσοι* [αλβ. *fucikaci*] στους Αλβανούς.

Δεύτερον, επειδή δηλώνουν ότι η γνώση που είχαν γι' αυτούς οι υπόλοιποι λαοί της Βαλκανικής δεν υπήρξε πάντα τόσο βαθιά και πλήρης. Η χρήση δε σχετικά πολλών εθνικών εκ μέρους των γειτονικών λαών αποδεικνύει ότι σε κάθε περίπτωση ήταν γνωστές μεμονωμένες ομάδες Αρωμούνων, που υποδηλώνουν τη μη κατανόηση της εθνικο-πολιτιστικής ενότητάς και συνόλου τους. Υπάρχουν, δηλαδή, εθνικά όπως *grabovar*, *frashëriot*, *sarakacan*, *dënce*.

Και οι ίδιοι οι Αρωμούνοι διαφοροποιούνται μεταξύ τους.

Σε ένα γενικότερο κατάλογο (αν και όχι περιεκτικό) για τους Αρωμούνους θα πρόκυπταν τα εξής εθνικά: *arumun*, *vllah*, *elinovllah*, *shqiptarovllah*, *maqedonovllah*, *kucovllah*, *mavrovllah*, *karavllah*, *çoban*, *çoban vendi*, *çoban mali*, *sarakacan*, *frashëriot*, *grabovar*, *dënce*, *cincar*, *fucikaci*.

Το πιο διαδεδομένο εθνικό είναι το *Βλάχος* [αλβ. *vllah*], που χρησιμοποιείται επίσης ως Β' συστατικό σχετικών συνθετικών.

Οι Αρωμούνοι ονομάζουν τον εαυτό τους *arâmân*, *armân* ή *râmân*.

Είναι ενδιαφέρον να τονισθεί ότι μεταξύ της Αλβανικής και Ελληνικής, όσον αφορά τα σχετικά εθνικά, υπάρχει κάποια διαφορά, που έγκειται στη χρήση τους σύμφωνα με τις λειτουργικές, περιστασιακές και γεωγραφικές παραλλαγές τους. Έτσι, λ.χ. ο όρος *çoban* χαρακτηρίζεται από αρνητική παραδίλωση. Χρησιμοποιείται, μαζί με άλλες λέξεις όπως *dënce*, *cincar*, *fucikaci* ως παρατσούκλι. Την ίδια χρήση γνωρίζει και ο όρος *sarakacan*.

Ο όρος «Βλάχος» στην Αλβανική δεν είναι φορτισμένος με αρνητική παραδίλωση. Ομοίως χρησιμοποιούνται και οι όροι *Μακεδονοβλάχος* [αλβ. *maqedonovllah*] ή *Ελληνοβλάχος* [αλβ. *elinovllah*].

Ο όρος Αρωμούνος [αλβ. *arumun*] είναι ο πιο διαδεδομένος που χρησιμοποιείται στην αλβανική βιβλιογραφία και στις βιβλιογραφίες άλλων χωρών.

Για να δημιουργηθεί μια ιδέα όσον αφορά την αλβανική «πολιτογράφηση» αυτών των όρων αρκεί να αναφερθούμε σε μια ενδιαφέρουσα παρατήρηση του Α. Ρίρα σχετικά με τον αριθμό των αλβανικών παραγώγων των εθνικών των βαλκανικών λαών. Στο Αλβανικό Λεξικό (1980) καταγράφονται έξι λήμματα με βάση το εθνικό *Βλάχος* [αλβ. *vllah*], όσα είναι και τα λήμματα με βάση το εθνικό *Αλβανός* [αλβ. *shqip*]: *vllah*, *vllahe*, *vllahe*, *vllahisht*, *vllahishte* (αντιστοίχως επίθετο, επίρρημα, όνομα γλώσσας) *vllahçe* (επίρρημα). Καταγράφονται πέντε λέξεις σχετιζόμενες με τη ρίζα *Αρωμούν-* (δεν υπάρχει επίρρημα με το επίθημα *-çë*). Αυτό αποδεικνύει ότι ο όρος *Βλάχος* [αλβ. *vllah*] είναι δημοφιλής, γνωστός από πρώιμες περιόδους και ευρέως διαδεδομένος στην αλβανική.